



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700261/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: Rekomandim për format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve gjatë ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve (kur preken fëmijët) nga institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës

Drejtuar: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit

Tiranë

Në median e shkruar, në gazetën "Sot", në datën 03.03.2017 është botuar shkrimi me titull "Policia dhe Përmbarimi nxjerrin në mes të katër rrugëve fëmijën paraplegjik".
(bashkelidhur shkrimin)

Në zbatim të nenit 13, të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar "Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike". Për një shqyrtim sa më objektiv të problematikës së publikuar në median e shkruar, dhe për të bërë të mundur mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme apo të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, Institucioni filloi shqyrtimin e çështjes.

Nga shqyrtimi i çështjes lidhur me të gjitha veprimet dhe mosveprimet që institucionet përgjegjëse kanë kryer gjatë ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit (konkretisht policia dhe përmbarusi) nuk është marrë parasysh "intersi më i lartë i fëmijës" gjatë kryerjes së procesit ku ka qënë i përfshirë edhe fëmija me aftësi të kufizuar.

Në nenin 54 të Kushtetutës thuhet se "Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti". si dhe në zbatim të Konvetës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe pikës 3, të nenit 6, të ligjit Nr. 8/2017 datë 23.2.2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" ku thuhet se "Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës; ku parim duhet të aplikohet gjerësisht në mënyrën e duhur në procedurat ligjore, administrative dhe gjyqësore.

Në zbatim të nenit 4, të ligjit Nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor” ku thuhet se “*Ligjshmëria dhe objektiviteti, si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim, janë parimet bazë të punës së Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor* si dhe në zbatim të VKM Nr. 266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe Udhëzimit nr.10, datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës” si dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”;

REKOMANDOJMË:

Marrjen e të gjitha masave të nevojshme gjatë ekzekutimit të vendimeve të detyrshme duke njoftuar zyrtarisht strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, në njësitë e qeverisjes vendore, duke garantuar ligjërisht interesin më të lartë të fëmijës ku direkt ose indirekt fëmijëve ju shkelen të drejta e tyre gjatë kryerjes së procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Në zbatim të nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar detyrimi i organeve të administratës për t’ju përgjigjur institucionit të Avokatit të Popullit është brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të shkresës zyrtare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI